



Trajneri italian i Teutes, Roberto Sorrentino ndihej i kenaqur me lojen e ekipit te tij ne kryeqytet, por shperdorimi i rasteve te krijuara nuk i dha mundesi skuadres durrsake te marri me shume se barazimi ndaj Tiranes. "Krijua epersi dhe patem disa raste per shenim.Kundershtari nuk rrezikoi pasi portieri yne nuk beri asnje pritje. Ne erdhem ketu per fitore por edhe barazimi nuk eshte i keq. Fituam javen e kaluar ne kampionat dhe ne mesjave per Kupe dhe kemi patur disa demtime te cilat na e kane nderlikuar lojen. Ashtu ndodhi edhe sot kur u detyruam te benim dy nderrime te domosdoshme per shkak demtimesh. Skuadra po luan mire. Na duhen 2-3 perforcime, por duhet t ekemi shume kujdes qe te afrojme ne ekip lojtaret e duhur", perfundoi prononcimin e tij per mediat, trajneri i Teutes, Roberto Sorrentino